



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

RAPORT I 6-MUJORIT TË PARË TË VITIT 2026 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhje ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (në vijim MTKS) ka publikuar 4 (katër) projekt-akte, objekt të konsultimit publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe të vendimit nr. 818, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025”, nga të cilat është miratuar 1 (një) projektligj: projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar.

MTKS ka publikuar edhe raportin individual për rezultatet e konsultimit publik, për këtë projektligj, duke përmbushur parimin e reagueshmërisë dhe llogaridhënies së këtij procesi.

Procesi i konsultimit publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e projekt akteve të gjithë pranuar dhe që reflektojnë interesin publik. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t’u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë, në të ardhmen.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2026, është kryer procesi i konsultimit për 4 projekt akte, nga të cilat është miratuar 1 (një) projektligj.

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MTKS ka miratuar 24 akte në gjashtëmuorin e parë të vitit 2026, nga të cilat 1(një) është projektligj dhe 23 (njëzet e tre) janë projektvendime.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka vijuar përmbushjen e detyrimit për konsultim publik të akteve, objekt i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Konkretisht, është realizuar konsultimi nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENjKP) dhe aktiviteteve të tjera konsultative, duke përfshirë grupet e interesit dhe duke administruar sugjerimet e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë konsultuar 4 (katër) akte, prej të cilëve është miratuar 1 (një) projektligj:

1. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, i ndryshuar (jashtë Planit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve) është miratuar;
2. Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin” (jashtë Planit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve) nuk është miratuar;
3. Projektligji “Për kinematografinë dhe audiovizualin” (brenda Planit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve) nuk është miratuar;
4. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Për Kulturën 2026–2030” (brenda Planit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve) nuk është miratuar.

2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar është shoqëruar me raport të vlerësimit të ndikimit rregullator, VNR.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Gjatë gjashtëmuorit të parë 2026, MTKS ka parashikuar për miratim në Planin e Përgjithshëm të projekt akteve 10 projekt akte, nga të cilat 9 projekt akte nuk i

janë nënshtruar procedurave të konsultimit publik, në përputhje me përcaktimet e shkronjës "c", të nenit 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, struktura e akteve të miratuara që iu nënshtruan konsultimit publik është 1 (një) projektligj.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me vitin e kaluar, ministria ka performuar mirë lidhur me këtë proces, duke diversifikuar metodat e përdorura për konsultim publik dhe duke i përzgjedhur ato në varësi të kompleksitetit të akteve. Përmirësimi i situatës është vërejtur sidomos në faktin se për 3 prej 4 akteve të konsultuara janë përdorur metoda të diversifikuara konsultimi publik.

Një problematikë që vlen të theksohet është se edhe pse ka shumë vizitorë, janë të paktë ata që lënë komente në portalin e Regjistrimit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si për shembull adresën e-mail për të përcjellë shqetësimet dhe sugjerimet e tyre.

2.2 Metodat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metoda e përdorur për konsultimin e projektligjit, ishte:

- Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK);

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar është publikuar në RENJK gjatë periudhës 13.2.2026-13.3.2026.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Nuk ka patur komente/sugjerime gjatë procesit të konsultimit, për këtë projektligj.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Jo, MTKS nuk ka realizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit të projektligjit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Procesi i konsultimit për projektligjin ka respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh pune të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.3.2 *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për aktet e publikuara në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike (RENJK) ka qenë 20 ditë pune.

2.3.3 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Situata paraqet përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme, si në respektimin e afateve, ashtu edhe në planifikimin e procesit.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1. *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

Projektligji është hartuar nga strukturat e MTKS.

2.4.2. *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Nuk janë përfshirë anëtarë të jashtëm, në grupin e punës për ndryshimet e realizuara në projektligj.

2.4.3. *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Nuk ka patur palë të interesuara gjatë procesit të konsultimit.

2.4.4. Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Nuk pati komente/sugjerime të administruara gjatë këtij procesi.

2.4.5. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata paraqitet e përmirësuar krahasuar me vitet e mëparshme. Vihet re një interes më i lartë për konsultimin e projekteve, i reflektuar në numrin e shikimeve të akteve të publikuara në RENJKP dhe në rritjen e ndërveprimit me grupet e interesit. Gjithashtu, është përmirësuar dokumentimi i procesit të konsultimit dhe reflektimi i komenteve në draftet përfundimtare të akteve. Gjithashtu, edhe në fazën e konsultimit përpara hartimit të projektaktit është vënë re dhënia e kontributit cilësor të grupeve të interesit.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, nuk ka patur komente.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nuk ka pasur rekomandime/komente.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Ka përmirësime lidhur me treguesin sasior, është rritur shkalla e konsultimeve publike të realizuara nga MTKS, duke rritur përdorimin e instrumenteve digjital dhe aksesin e grupeve të interesit dhe publikut në vendimmarrje.

Interesi i publikut në dhënien e komenteve/sugjerimeve gjatë procesit të konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i vlerësimit të ndikimit rregullator nuk ka pësuar ndryshime pas procesit të konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, MTKS ka publikuar 1 (një) raport individual konsultimi, për projektligjin e miratuar.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyt?

Nuk ka raport të pa publikuar.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik *(Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)*

MTKS vlerëson se procesi i konsultimit publik për projektligjin është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, duke garantuar transparencën, aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik vazhdojnë të lidhen edhe këtë vit më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces. Gjithsesi theksojmë se situata e ndërgjegjësimit sa vjen e përmirësohet, referuar edhe numrit të shikimeve të projektakteve në RENJK, duke kuptuar rëndësinë e komentimit përmes këtij regjistri, pasi është drejtpërdrejt i monitoruar nga Kryeministria duke shtuar kontrollin në reflektimin e komenteve të përcjella përmes RENJK.

Gjithashtu, krahas publikut duhet të ketë një angazhim më të madh të strukturave teknike hartuese të akteve, pasi krahas bashkëpunimit dhe dhënies së kontributit për identifikimin e grupeve të interesit të përfshira, nevojitet informimi përmes zhvillimit të trajnimeve, mbi rëndësinë e procesit të konsultimit publik të projektakteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm gjatë procesit të konsultimit, edhe me qëllim rritjen e cilësisë së performancës në këtë proces.

Si përfundim, me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit, synohet sërish ndërgjegjësimi edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacionit.